



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

Lënda: Kthim përgjigje.

KN
ZNJ. G.D

E nderuar {...}

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj, ardhur përmes postës elektronike, në datë 11.05.2021, regjistruar me numër rendor 20, datë 11.05.2021, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2098 Prot., datë 11.05.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin Nr. 30/2020, datë 16.4.2020, miratoi Aktin Normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”.

Akti Normativ Nr. 9/2020, tashmë ligj, përmban disa kufizime, **deri në përfundim të epidemisë Covid-19**. Sa kohë që ky ligj është në fuqi dhe gjendja e epidemisë vazhdon, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe gjykatat nuk mund të vendosin rifillimin e veprimtarisë së plotë gjyqësore. Sa i përket vijimit të veprimtarisë gjyqësore, në kushtet aktuale të pandemisë, me vendimin nr.143, datë 22.4.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, më datë 27.4.2020, duke ngarkuar këshillat dhe kryetarët në detyrë të gjykatave për marrjen e masave për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, në përputhje dhe respektim të masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19, në respektim të dispozitave të Akti Normativ Nr. 9/2020. Vendimmarrja e KLGJ në lidhje me situatën e Covid-19, gjendet në linkun e mëposhtëm:

<http://klgj.al/covid-19/>.

Me tu njohur shqetësimin e ngritur nga ana juaj, lidhur me pjesëmarrjen e mediave në seancat gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përfaqësues të Këshillit kanë diskutuar me znj. Saida Dollani, Gjyqtare e Medias, për juridiksionin e gjykatave të posaçme, e cila nga ana e saj ka zhvilluar një takim me znj. Irena Gjoka, në cilësinë e drejtueses në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar. Pas këtij takimi, znj. Gjoka në cilësinë e drejtueses në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është angazhuar për marrjen e masave për garantimin e aksesit në seancat gjyqësore, për një numër të kufizuar të përfaqësuesve të mediave, duke respektuar me rigorozitet masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Për të mundësuar lehtësimin e punës së administratës gjyqësore, përfaqësuesit e mediave rekomandohet të bëjnë kërkesë zyrtare për seancat gjyqësore për të cilat gjykohet se ka interes të posaçëm tek publiku.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!